

GJYKATA E QARKUT PRISHTINË**P. Nr. 10/2007**

27 mars 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

Gjyqtari i EULEX-it, z. Francesco Florit, Kryetar
Gjyqtari i EULEX-it, z. Andrea Cruciani,
Gjyqtari Vendor, z. Hamdi Ibrahim,imi,

Të ndihmuar nga procesmbajtësja Liz Bateman

Në çështjen penale kundër:

1) Feriz Gashi, djali i Hysniut dhe Elfetes (mbiemri i vajzërisë Beqa), lindur më 10 tetor 1974, në Prishtinë, me adresën e përhershme në rrugën "Tirana", pa numër, Shtimje, i papunë, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, kosovar shqiptar, në paraburgim që më 22 prill 2006, akuzuar për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, sipas Nenit 147, Par. 1, Pikat 4 dhe 11 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Mbajtjes, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, sipas Nenit 328, Par. 2 të KPPK.

2) Hysni Gashi, djali i Azizit dhe Ajshes (mbiemri i vajzërisë Zogaj), lindur më 6 gusht 1949, në fshatin Pjetërshticë, Komuna e Lipjanit, me adresën e përhershme në rrugën "Tirana", pa numër, Shtimje, rrobaqepës, i martuar, baba i tetë fëmijëve, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, kosovar shqiptar, në paraburgim paragjyqësor që më 22 prill 2006 deri më 9 janar 2007, e pastaj në paraburgim shtëpiak, që më 10 janar 2007 deri më 12 maj 2008, akuzuar për veprën penale të Nxitjes për të kryer veprën penale të Vrasjes së Rëndë, sipas Neneve 24 dhe 147, Par. 1, Pikat 4 dhe 11 të KPPK.

Pas gjykimit kryesor të mbajtur më 11, 12, 19 shkurt dhe 4, 5, 12, 24 dhe 27 mars 2009, në prezencën e Prokurorit Publik, z. Lulzim Sylejmani, të Akuzuarve dhe Avokatëve Mbrojtës, Bajram Tmava (për Feriz Gashin) dhe Fazli Balaj (për Hysni Gashin), publikisht shpall aktgjykimin e mëposhtëm:

AKTGJYKIM1) **Feriz Gashi** shpallet fajtor

për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Par.1, Nënpar. 4 dhe 11 të KPK, dhe për veprën penale të Mbajtjes, dhe Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Par. 2 të KPK.

2) Hysni Gashi shpallet fajtor

për veprën penale të Nxitjes për të kryer veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me Nenet 24 dhe 147, Par. 1, Nënpar. 4 dhe 11 të KPK.

Sepse të dy të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprat penale me të cilat akuzohen, në aktakuzën e dorëzuar nga Prokurori Publik dhe veçanërisht:

Feriz Gashi

1.Më 22 prill 2006, rreth orës 09:30 në Shtimje, rruga “Tirana”, në tarracën e kafenesë “Prestigj”, me qëllim ka privuar nga jeta tani të ndjerët, Vezir Bajrami dhe Aziz Xhelili, dhe gjithashtu në të njëjtën rrugë dhe përgjatë së njëjtës kafene, ai ka tentuar të privojë nga jeta: Burim Bajramin, Kadri Bajramin, Ekrem Feratin, Besnik Feratin, Rifat Imerin, Hamdi Hasanin, Xhemajl Smajlin, Ibrahim Halilin, dhe gjithashtu ka rrezikuar jetën e personave të ndryshëm në vendin në fjalë dhe në apartamentet afër këtij vendi, të gjitha këto ai i ka bërë duke qenë i motivuar për shkak të mosmarrëveshjeve mes familjes së tij dhe Kadri Bajrami e Ekrem Ferati, një mosmarrëveshje mbi nja parcelë toke, e cila gjendet në të njëjtin vend në Shtimje, rruga “Tirana”, ku gjendet një shtëpi me dy lokale biznesi, e që ishin përdorur për të banuar e për të punuar nga i pandehuri Feriz Gashi dhe familja e tij që më 1999, pas luftës në Kosovë, dhe të cilat, palët e lënduara, Ekrem Ferati dhe Kadri Bajrami i kishin blerë nga një pronar serb, dhe ndërkohë që pronarët, Ekrem Ferati dhe Kadri Bajrami, në të njëjtën ditë, 22/ 04/ 2006 rreth orës 09:30, kishin organizuar rrënimin e lokaleve të sipërpërmendura, të quajtura “Cami”, me një ekskavator dhe ndërkohë që pala e lënduar, Burim Bajrami po zbriste ekskavatorin nga një maune në rrugën përkundrejt këtyre dy lokaleve, i pandehuri Feriz, i fshehur në të njëjtat lokale, duke pasur me vete një armë automatike të Tipit 68, me numër serie 10232985, të kalibrit 7.62x39 mm dhe tre granata dore të një tipi të panjohur, të cilat po i mbante pa leje të vlefshme nga organi autorizues, fillimisht qëllon disa herë me armën e tij automatike në drejtim të kabinës së ekskavatorit, ku ishte Burim Bajrami, dhe përgjatë rimorkios së maunes (kamionit), ku ishin Kadri Bajrami dhe Ekrem Ferati, pasta jai vazhdon të qëllojë në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje, po ashtu edhe në drejtim të tarracës së kafenesë “Prestigj”, e cila gjendet në anën e kundërt të lokaleve të biznesit “Cami”, përtej rrugës “Tirana”, në një largësi prej 20-25, dhe ku po qëndronin në një tavolinë tani të ndjerët, Vezir Bajrami dhe Aziz Xhelili. Pasi qëlloi rreth 57 herë në mënyrë të vazhdueshme, ai hodhi tre granata dore në drejtim të rrugës së përmendur, dhe ku njëra prej tyre bie afër një oficeri policie të SHPK-së, Ibrahim Haliti, fatmirësisht pa shpërthyer. Si pasojë e këtyre të shtënave me armë automatike në këto pjesë të vendit dhe përreth tij, tani i ndjeri, Vezir Bajrami u qëllua nga një plumb në anën e majtë frontale të krahavorit, ndërsa, tani i ndjeri, Aziz Xhelili u qëllua nga tri plumba, dy plumba në pjesën e përparme të krahut të tij të djathtë dhe një plumb në anën e djathtë të krahavorit. Si pasojë e veprimit mekanik të plumbave, që të dy përjetuan shok dhe hemorragji, dhe për

këtë arsye, që të dy u larguan nga jeta në të njëjtën ditë, ndërsa pala e lënduar, Albiona Jashari, e cila ishte në apartamentin e saj praën një dritareje, ishte qëlluar nga këto të shtëna me një plumb në kokë, duke shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore. Për më tepër, Besnik Ferati u qëllua nga një plumb në krahun e tij të majtë, që shkaktoi kështu lëndime të rënda trupore, e pastaj, po si pasojë e të shtënave në pjesën e fortë të betonit, Hamdi Hasani dhe Xhemajl Smajli u qëlluan në kokat e tyre nga copa betoni, që shkaktuan kështu lëndime të lehta trupore; Burim Bajrami u qëllua nga një plumb në gjurin e këmbës së majtë, ndërsa Ekrem Ferati u qëllua me një plumb në veshin e tij të djathtë; Rifat Imeri u qëllua nga dy plumba në anën e majtë të kokës, pas veshit, duke shkaktuar kështu lëndime trupore. Pasi mbaruan të shtënat, policia arrestoi të pandehurin dhe në këtë rast gjeti dhe sekuestroi armën e tij automatike.

Hysni Gashi

2. Më 22 prill 2006, në orët e mëngjesit, në Shtimje, në rrugën "Tirana", në shtëpinë ku ai jetonte me familjen e tij, me qëllim ai nxiti djalin e tij, Feriz Gashi (tashmë i pandehur) për të kryer veprën penale të "Vrasjes së Rëndë", sipas të gjitha rrethanat e përshkuara në akuzën 1 të listës së akuzave të kësaj aktakuze, dhe ai i ka bërë të gjitha këto duke qenë i motivuar nga një mosmarrëveshje që ai ka pasur me palët, Kadri Bajrami dhe Ekrem Ferati, të cilët, më herët kishin blerë ligjërisht një pjesë të kësaj parcele të paluajtshme nga një pronar serb, në të cilën gjenden dy lokale biznesi të quajtura "Cami", e të cilat janë uzurpuar nga i pandehuri Hysni, dhe një shtëpi në të cilën po jetonte i pandehuri Hysni me anëtarët e tij të familjes, që nga viti 1999, në mënyrë të tillë që ndërsa Kadri Bajrami dhe Ekrem Ferati më 22.04.2006, rreth orës 09:30 kishin organizuar veprimtaritë në lidhje me rrënimin e këtyre dy objekteve që gjenden në rrugën "Tirana", me qëllim që të kishin hapësirë për to dhe t'i përdornin për qëllimet e tyre, dhe kur i pandehuri Hysni u kthye nga Stacioni i Policisë së Shtimjes, pak kohë më parë, dhe duke pasur dijeni për faktin se këto dy dyqane do të rrënoheshin atë mëngjes, e ka bindur djalin e tij, të pandehurin Feriz Gashi, që nëse anëtarët e familjeve të Kadri Bajramit dhe Ekrem Feratit tentonin të rrënonin objektet e përmendura, të qëllonte me armën automatike dhe në asnjë mënyrë të mos lejonte rrënimin e tyre, për arsyen e vetme që të mos e lëshonte parcelën dhe objektet në fjalë nga posedimi aktual i tij, dhe kjo është ajo që në fakt ndodhi, kur në të njëjtën ditë, më 22.04.2008, rreth orës 09:30, i pandehuri Feriz Gashi ka privuar nga jeta me armën e tij automatike, tani të ndjerët, Vezir Bajrami dhe Aziz Xhelili, dhe ka tentuar gjithashtu të privojë nga jeta të gjitha palët e lënduara, siç janë përmendur në akuzën 1 të listës së kësaj aktakuze, duke u shkaktuar atyre lëndime trupore.

Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, Trupi Gjykses lëshon dënimin e mëposhtëm:

DËNIM

- 1) Feriz Gashi

Në bazë të Nenit 37 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenit 147, Par. 1, Pikat (4) dhe (11) dënohet me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim;

Në bazë të Nenit 38 dhe Nenit 328 (2) të KPK, dënohet me 1 (një) vit burgim;

Në bazë të Nenit 71, Par. 1 dhe 2, Pika 2 të Kodit Penal të Kosovës, i pandehuri Feriz Gashi do të vuajë një dënim unik prej 25 (njëzet e pesë) vitesh e 6 (gjashtë) muajsh burgim.

Koha që Feriz Gashi ka kaluar në në paraburgim që nga data 22 prill 2006 deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, do të përlllogaritet si pjesë e vuajtjes së dënimit, sipas Nenit 73 të Kodit Penal të Kosovës.

2) Hysni Gashi

Në bazë të Nenit 38 dhe Nenit 24 të KPK lidhur me Nenin 147, Par. 1, Pikat 4 dhe 11 të KPK dënohet me 20 (njëzet) vjet burgim.

Trupi gjykues ka urdhëruar paraburgimin kundër Hysni Gashit, me efekt të menjëhershëm, deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë.

Koha që Hysni Gashi ka kaluar në paraburgim/paraburgim shtëpiak që nga data 22 prill 2006 deri më 12 maj 2008, e që sot deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, do të përlllogaritet si pjesë e vuajtjes së dënimit, sipas Nenit 73 të Kodit Penal të Kosovës.

PADIA PRONËSORE

Të akuzuarit, së bashku dhe në veçanti, do të kompensojnë palët e lënduara Gojart Bajrami, Nazif Xhelili, Burim Bajrami, Kadri Bajrami, Besnik Ferati, Rifat Imeri, Hamdi Hasani, Xhemajl Smajli, Albiona Jashari, Fitim Ferati, për dëmet e shkaktuara. Të dhant e përcaktuara në procedurën penale nuk përbëjnë një bazë të mirëfilltë as për kompensim të plotë, dhe as për kompensim të pjesshëm; prandaj Gjykata i udhëzon palët e lënduara të ushtrojnë padi civile në lidhje me të gjitha dëmet, sipas Nenit 112 (2) të KPPK.

KONFISKIMI

Në bazë Nenit 60 të KPK dhe Nenit 489 të KPPK, arma automatike e tipit 68, me numrin serial 10232985, e kalibrit 7. 62mm x 39 mm, konfiskohet.

SHPENZIMET

Në bazë të Nenit 102, Par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e dënuar do të paguajnë shpenzimet e procedurës. Do të përmbushen dispozitat e Nenit 100, Par. 2 të KPPK, dhe do të lëshohet një vendim i veçantë në lidhje me sasinë e shpenzimeve.

ARSYETIMI

I. Historiku i Procedurës

Më 25 prill 2006, Prokurori Publik ka lëshuar një vendim për fillimin e hetimeve, PP. Nr. 239-1/06, në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, kundër të dyshuarve të mëposhtëm: **Feriz Gashi**, për veprat penale të Vrasjes së Rëndë, Tentativës së Vrasjes së Rëndë, Armëmbajtje e Paligjshme e Armëve dhe Shkaktimi të Rrezikut të Përgjithshëm; **Hysni Gashi**, për veprën penale të Kërcënimit; **Izjah Beqa**, për veprën penale të Armëmbajtjes së Paligjshme të Armëve; **Sami Gashi**, për veprën penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm; **Kadri Bajrami**, për veprat penale të Armëmbajtjes së Paligjshme të Armëve dhe Pengimin e Personave Zyrtarë në Kryerjen e Funksioneve të tyre Zyrtare. Në të njëjtin vendim edhe **Burim Bajrami**, **Ekrem Ferati** dhe **Rifat Imeri** ishin listuar si të dyshuar për veprën penale të Armëmbajtjes së Paligjshme të Armëve.

Më 21 shtator 2006, Prokurori Publik e ka zgjeruar hetimin edhe kundër **Hysni Gashit**, për të përfshirë veprën penale të Nxitjes për të kryer veprën penale të Vrasjes së Rëndë.

Më 20 tetor 2006, Gjyqtarja e Procedurës Paraprake të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Drita Hoxha, e ka zgjeruar hetimin edhe për një periudhë prej gjashtë muajsh kundër të gjithë të dyshuarve të listuar më sipër.

Më 10 janar 2007, Prokurori Publik e ka ndërprerë hetimin kundër të dyshuarve të mëposhtëm: **Izja Beqa**, **Ismajl Beqa**, **Sami Gashi**, **Blerim Gashi**, **Ekrem Ferati** dhe **Rifat Imeri** për veprat penale të sipërpërmendura.

Në po të njëjtën ditë, Prokurori Publik ka dorëzuar një aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër **Feriz Gashit**, për veprat penale të Vrasjes së Rëndë dhe Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, dhe kundër **Hysni Gashit**, për veprën penale të Nxitjes për të kryer veprën penale të Vrasjes së Rëndë.

Më 6 mars 2007, Gjyqtari Konfirmues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, **Selman Bogiqi**, ka mbajtur seancën konfirmuese dhe ka konfirmuar aktakuzën kundër **Feriz Gashit** dhe **Hysni Gashit**, për veprat penale si të listuara në aktakuzë.

Gjykimi kryesor ka filluar më 18 qershor 2007, përpara një trupi gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë (Kryetar i Trupit Gjykues - **Elez Hoxha**). Seancat e mëtejshme janë mbajtur më 10 shtator, 15 tetor, 26 nëntor, 8 janar 2008, 25 shkurt, 27 mars dhe 21 prill 2008.

Gjatë seancës së fundit, Kryetari i Trupit Gjykses, Elez Hoxha, ka listuar një inspektim të vendit të ngjarjes për datën 15 maj 2008, si edhe një datë për një seancë të mëtejshme gjykimi për datën 23 qershor 2008.

Megjithatë, seanca e datës 23 qershor nuk u mbajt asnjëherë, dhe për çështjen u caktua një Kryetar i ri i Trupit Gjykses, z. Mejd Dehari.

Pas një letre që i akuzuari Feriz Gashi kërkonte që çështja të gjykohej nga gjyqtarët e EULEX-it, Kryetari i Trupit Gjykses, z. Mejd Dehari, i dërgoi një letër gjyqtarit të EULEX-it, Franceso Florit, më 3 dhjetor 2008, dhe ia dorëzoi dosjen e lëndës për ta marrë në konsideratë gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Më 12 dhjetor 2008, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Maria Giuliana Civinin, lëshoi një vendim me anë të të cilit e aprovonte kërkesën për të caktuar gjyqtarë të EULEX-it për çështjen, në bazë të Nenit 3.3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Me anë të të njëjtit vendim, ajo caktoi Gjyqtarin e EULEX-it, Francesco Florit, si Kryetar të Trupit Gjykses, dhe Gjyqtarin e EULEX-it, Andrea Cruciani, ai anëtar të trupit gjykses.

Gjykimi kryesor filloi më 11 shkurt 2009, përpara trupit gjykses të përbërë si më sipër.

Në prezencën e të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës, palëve të lënduara dhe përfaqësuesve të tyre, kryetari i trupit gjykses konfirmoi që trupi gjykses është formuar në përputhje me ligjin. Juridiksioni i gjyqtarëve të EULEX-it në këtë çështje, është bazuar në dispozitat e Nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Nuk ka pasur kundërshtime nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykses.

Gjatë së njëjtës seancë, u lexua aktakuza nga Prokurori Publik; të pandehurit u pyetën nëse e konsideronin veten fajtorë apo të pafajshëm. Të gjithë të akuzuarit e kanë deklaruar veten të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Në po të njëjtën ditë, Gjykata dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve dhe palëve të lënduara, Rifadije Jashari dhe Xhemajl Smajli.

Më 12 shkurt 2009, pas përfundimit të marrjes në pyetje të Xhemajl Smajlit, Gjykata dëgjoi Dëshmitarët Burim Bajrami, Rifat Imeri dhe Hamdi Hasani.

Më 19 shkurt, Gjykata dëgjoi dëshmitë e Dëshmitarëve Kadri Bajrami, Fitim Ferati, dhe dëshmitarëve Ibrahim Halili e Agni Musliu.

Më 4 mars 2009, Gjykata dëgjoi dëshmitë e dëshmitarit Naser Tërshani, të Dr. Tefik Gashit, si Ekspert i Mjekësisë Ligjore, dhe dëshminë e Rreshterit të Policisë, Lutfi Rraci, si Ekspert i Balistikës, në lidhje me ekzaminimin e armëve.

Më 5 mars 2009, Gjykata dëgjoi dëshminë e dëshmitarit Shaip Mujota dhe pranoi si prova, dokumentet e mëposhtme:

1. Zixhiri i ruajtjes
2. Raporti mbi vendin e ngjarjes
3. Skicën e vendit të ngjarjes bashkë me shpjegimet
4. Rekomandimi (në gjuhën Shqipe, i bashkëngjitur raportit të policisë)
5. Dokumenti që është përshkrimi i fotografive Nr. 1 – 376
6. Raporti nga njësia e policisë së Ferizajit
7. Raporti mbi autopsinë
8. Përshkrimi i fotografive të autopsisë
9. Një album fotografik të autopsisë me 91 fotografi
10. Një raport tjetër mbi vendin e ngjarjes
11. Një skicë të datës 27 prill 2006
12. Zixhiri i ruajtjes
13. Një listë tjetër fotografish të datës 27 prill 2006
14. Rekomandimin
15. Kallëzimin penal të datës 22 prill 2006
16. Një listë tjetër fotografish të datës 27 prill 2006
17. 33 fotografi
18. Raporti mjekësor i hartuar nga Dr. Tefik Gashi, që mban datën 18 – 20 qershor 2007
19. Raporti balistik që mban datën 25 gusht 2006.
20. Dëshmia e Besnik Feratit
21. Vendime të Gjykatës dhe dokumente që kanë të bëjnë me padinë civile në lidhje me pronën.

Në të njëjtën seancë, gjykata vazhdoi me marrjen në pyetje të të pandehurve. Feriz Gashi dhe Hysni Gashi kërkuan që trupi gjykues të përjashtojë publikun, sipas Nenit 329, Par. 4 të Kodit të Proçedurës Penale të Kosovës (KPPK). Kërkesa u pranua brenda kufijve të Nenit 330 të KPPK. Hysni Gashi e dha dëshminë e tij, ndërsa Feriz Gashi vendosi të qëndronte në heshtje, për arsye të masave të pamjaftueshme të supozuara.

Më 12 mars 2009, vazhdoi marrja në pyetje e të akuzuarit Hysni Gashi.

Më 24 mars 2009, Gjykata dëgjoi fjalët përfundimtare. Në përfundim të seancës, i pandehuri Feriz Gashi i kërkoi trupit gjykues të përjashtojë nga të qenit present gjatë shpalljes së aktgjykimit. Kërkesa e tij u aprovua.

Më 27 mars 2009, trupi gjykues shpalli publikisht aktgjykimin. Në mungesë të Feriz Gashit, aktgjykimi iu komunikua atij, në qendrën e paraburgimit ku edhe mbahej.

Të Dhënat Faktike dhe Vlerësimi i Provave

Gjykata vlerëson se faktet e përshkruara në aktakuzë janë provuar dhe se të akuzuarit janë fajtorë në lidhje me akuzat e listuara në aktakuzë.

Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor, ngjarjet që kanë ndodhur në Shtimje më 22 prill 2006, janë përshkruar tërësisht nga dëshmitarët, edhe me një kontribut tjetër të të akuzuarit Hysni Gashi, gjatë marrjes së tij në pyetje. Përveç kësaj, dokumentet e mbledhura nga Prokurori Publik dhe që gjenden në *dossier*, ilustrojnë më tej faktet dhe mbështesin provat e mbledhura nga Gjykata.

Gjatë zhvillimit të gjykimit kryesor, faktet kryesore (p.sh. të shtënat me breshëri në ditën kritike, të cilat shkaktuan vdekjen e dy personave dhe lëndimin e disa të tjerëve), janë vendosur në një farë konteksti, në një skenar edhe më të gjerë, që përfshinte ngjarje që kishin ndodhur para disa vitesh, që nga koha e përfundimit të konfliktit (qershor 1999), e deri në prag të këtyre të shtënave.

Në këtë drejtim, ekspozohet e gjithë historia e mosmarrëveshjes që rrethon pronën e personave të përfshirë në gjykimin kryesor si të akuzuar, viktimës (Vezir Bajrami) apo dëshmitarit (Kadri Bajrami). Përmes fjalëve të të njëjtit të akuzuar, është përcaktuar fillesa e gjithçkaje që ka ndodhur më vonë (okupimi i pronës më 16 qershor 1999, siç është deklaruar gjatë zhvillimit të seancës së gjykimit kryesor më 5 mars 2009, (faqja 16, e versionit anglisht). Paditë e ndryshme civile që u ngritën dhe tentativat e ndryshme për të ekzekutuar vendimet e Gjykatës Komunale të Ferizajit dhe të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, u ilustruan, së bashku me takimet e shumta, diskutimet, ndërmjetësimet, që të dyja palët kishin bërë me kalimin e viteve, me qëllim që të tentonin të gjenin një zgjidhje në lidhje me mosmarrëveshjen mes tyre.

Kjo teknikë e prezantimit të fakteve në një kontekst më të gjerë, që u ndoq nga prokurori dhe që faktikisht u pranua edhe nga mbrojtësit, duhet të kuptohet, kishte dy qëllime.

Së pari, ajo ofronte mundësinë që Gjykata të mësonte fakte në lidhje me çështjen siç kishin ndodhur ato në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, duke pasur avantazhin, për shembull, të paraqiteshin në mënyrë të plotë aspektet psikologjike të të akuzuarve (për shembull, insistimi i z. Hysni Gashi që të gjendej një zgjidhje, të paktën në fillim; (këmbëngulja e tij në mospranimin e ‘mëkatit të tij fillestar’, p.sh. okupimi fillestar pa ndonjë titull, në fund), dhe insistimi i viktimës (p.sh. zgjidhja përfundimtare e Kadri Bajramit e përmbledhur në fjalinë: “Që kur linda e derisa të vdes”, që është raportuar nga i akuzuari Hysni Gashi gjatë seancës së datës 5.3.09).

Së dyti, ajo hodhi bazat mbi përgjegjësinë e nxitjes së Hysni Gashit. Një lloj përgjegjësie, e cila mund të provohet me vështirësi vetëm mbi deklaratën e një dëshmitari (i cili duhet të kishte dëgjuar babain që po i jepte djalit urdhrin vrasës...)

por që në të kundërtën, mbështetet nga disa elementë që gjenden në prezantimin e provave si baza të qëndrueshme, siç do të thuhet edhe më vonë.

Në fund, teknika e prezantimit të fakteve përmes 13 dëshmitarëve, provoi të ishte pozitive, edhe pse, disa herë e gjatë (duke pasur parasysh nevojën e përkthimit).

Dhe duhen admiruar avokatët, përse i përket përvojës dhe mirësjelljes së tyre, kur edhe në momentet më të vështira që i përjeton gjithnjë një gjykim kryesor, për kontributin e tyre besnik në lidhje me paraqitjen e fakteve në mënyrë të drejtë.

Në përgjithësi, marrja në pyetje e 13 dëshmitarëve nuk ka vuajtur mjaft, duke pasur parasysh mosmarrëveshjet dhe konfliktet mes palëve, të cilat disa herë ndikojnë në marrjen në pyetje të personave që japin dëshmi, me kundërshtime të përsëritura apo kërkesa për qartësim, me alternative të përsëritura ndaj mekanizmit të pashmangshëm e të hollësishëm të konfrontimit të dëshmitarëve me deklaratat e mëparshme dhënë hetuesve apo prokurorit. Nuk ka pasur as nevojë që të konfrontohen dy dëshmitarë, dhe as nuk kemi ndihmuar në lidhje me ndonjë numër të madh pyetjesh sugjестive.

Dhe nuk ka nevojë që të them, se kjo ka ndihmuar mjaft për një atmosferë të qetë në Gjykatë gjatë zhvillimit të seancave.

Në përgjithësi, dëshmitarët kanë qenë të qëndrueshëm si në përshkrimin e rrethanave që kanë çuar në ditën kritike (p.sh. aspektet e mosmarrëveshjes civile mes Gashit dhe Bajramit), por edhe në përshkrimin e fakteve të datës 22 prill 2006.

Shumica e dëshmitarëve (8 nga 13, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë) kanë qenë thelbësisht të paanshëm dhe nuk kanë pasur ndonjë arsye të mbajnë krahun e njëres palë, apo tjetrës.

Dëshmitarët si Rifadije Jashari (nëna e vajzës së vogël Albiona), Xhemajl Smajli (pronari i lokalit Fast-Food), Ibrahim Halili (oficeri i policisë), Agni Musliu (një kalimtar) apo Naser Tërshani (pronari i kafenesë 'Prestigj'), mund të kenë pasur arsyet e tyre personale ndaj atyre personave të cilët ata i identifikojnë si shkaktarët e dëmeve të tyre. Por ata nuk kanë pasur ndonjë paragjykim apo ndonjë predispozitë të bazuar mbi lidhje familjare.

Po ashtu, edhe Fitim Ferati, edhe pse i lidhur më së pakti me klanin Ferati (ai është kushëri i tretë i Ekrem Feratit, siç ka deklaruar), ka marrë pjesë vetëm sepse në anë të vendit të ngjarjes ai kishte një dyqan të vetin, të cilin e hapte çdo ditë, kur filluan të shtënat.

Tefik Gashi dhe Lufti Raci nuk mund të kundërshtohen si dëshmitarë ekspertë. Pavarësia e tyre e natyrshme (ata i shqyrtojnë faktet *ex post*, ata janë profesionistë 'institucionalë' apo 'neutralë') është mbështetur nga kompetenca që ata kanë

demonstruar gjatë marrjes së tyre në pyetje. Marrja e tyre në pyetje nuk është kundërshtuar.

Përsa i përket grupit të mbetur të dëshmitarëve, nuk mund të anashkalohej fakti se ata i përkasin së njëjtës familje apo janë në njëfarë mënyre të lidhur familjarisht. Kadri Bajrami, përveç faktit se ka qenë i përfshirë në një padi civile, ishte edhe vëllai i të ndjerit; Hamdi Hasani është vjehri i Kadri Bajramit; Burim Bajrami është nipi i Kadri Bajramit.

Pavarësisht nga këto, dëshmitë e tyre nuk janë kundërshtuar në lidhje me aspektet që kishin të bënin me mosmarrëveshjen e gjatë mes Bajramit dhe Feratit, nga njëra anë, dhe të Gashit, nga ana tjetër.

Po ashtu, në lidhje me rrethanat e të shtënave, versionet e tyre mbështeten plotësisht nga provat e tjera materiale, siç do ta kemi mundësinë të shohim edhe më poshtë.

Për dëshmitarët e mbetur, (Rifat Imeri dhe Shaip Mujota), mund të thuhet fare pak.

I pari paraqet një kërkesë të ngatërruar mbi kompensimin e dëmeve (për paraburgim të paligjshëm dhe dëme fizike), por ka dhënë një version të thjeshtë dhe të ndershëm në lidhje me faktet.

Dëshmitari i dytë jep dëshmi në lidhje me një episod që ka ndodhur pas ngjarjeve, siç janë përshkruar në aktakuzë. Rrethanat për të cilat është marrë në pyetje dëshmitari nuk kanë qenë themelore dhe të rëndësishme përsa i përket kuptimit të fakteve.

Nuk duket se është e nevojshme, në këtë fazë, të shqyrtojmë me hollësi çështjen e mosmarrëveshjes civile në lidhje me pronësinë (nga Bajrami dhe Ferati), dhe okupimin (e paligjshëm) të tokës nga Gashi: rindërtimet e të gjitha fakteve të dhëna nga dëshmitarët, krahasuar me deklaratat e të njëjtit të akuzuar, Hysni Gashi, i cili gjatë marrjes në pyetje, më 5 dhe 12 mars, ka detajuar me hollësi, me një kujtesë të çuditshme, secilën datë përkatëse të ngjarjeve.

Mjafton të thuhet se ka dalë si e pakundërshtueshme natyra e paligjshme e okupimit të tokës nga Hysni Gashi, që e ka pasur origjinën në një okupim fillestar *de facto*, që është lejuar apo autorizuar vetëm nga Autoriteti Ushtarak (KFOR-i finlandez), por që më pas nuk është ratifikuar kurrë ligjërisht. Një posedim toke *sine titulo*, nuk është pasur asnjëherë nga një marrëveshje shitblerjeje të shitjes së pronës mes Hysni Gashit dhe 'Radomirit' (një serb apo malazez, pronar i pronës). Në atë situatë të çuditshme ligjore, sigurisht ka qenë e pamundur, për Hysni Gashin, të jetë në anën e drejtë të mosmarrëveshjes ligjore: në të vërtetë, si në nivelin e shkallës së parë, ashtu edhe në nivelin ankimues, Hysni Gashi ka humbur, siç e konfirmon edhe dokumenti (vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajit dhe vendimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës). Ekzekutimi i vendimit, pa pasur parasysh nëse do të ishte jo i suksesshëm përballë

rëzistencës së të akuzuarit, i cili u kthye përsëri tek lokalet e evakuuara më parë, ishte pasojë e llogjikshme.

Çfarë kuptimi ka të shtjellohet më tej çështja? Çfarë nevoje ka të ilustruhet në detaje të mëtejshme zhvillimi i procedurës apo hapat dhe përpjekjet e bëra nga palët për të gjetur një lloj forme marrëveshjeje alternative, larg gjykatave, larg ndërhyrjes së gjyqësorit?

I njëjti i akuzuar ka listuar një sërë datash: për shembull, 16 qershor 1999, siç është thënë; apo, 4 shkurt, takimi me Habitatin dhe dhënia e një lejeje; apo, fillimi i vitit 2001, zjarri në ndërtesë; apo datat, 6/7 shkurt 2001, telefonata me pronarin dhe vendimi për të blerë; apo data tragjike (për Gashin), ajo e 19 gushtit, kur marrëveshja mes pronarit dhe Ekrem Feratit për blerjen e tokës për një çmim më të lartë, filloi grindjen. I akuzuari shtoi edhe mjaft data të tjera, dhe apo ashtu datat u shtuan (ndonjëherë) edhe nga dëshmitarët. Por, përsëri, kjo ka pak kuptim, që t'i përsërisim ato këtu, për arsyen e thjeshtë se asnjë përpjekje apo ndërmjetësim nuk mund të silltet si justifikim apo të paraqitet si lehtësim, për atë që ka ndodhur në Shtimje në mëngjesin e ditës kritike.

Ngjarjet që i kanë paraprirë të shtënave, mund të kenë ndihmuar që gjërat të vendosen në një lloj perspektive, por mos ofroni justifikime ligjore në lidhje me aktin e të qëlluarit dhe pasojat e tij (vdekjen e Vezir Bajramit dhe Aziz Xhelalit)!

Ajo që ka ndodhur në rrugën "Tirana", në Shtimje, në mëngjesin e datës 22 prill 2006, është përshkruar me saktësi të mjaftueshme nga dëshmitarët. Tregimi i të akuzuarit Hysni Gashi e ka kompletuar përshkrimin e fakteve dhe ka qartësuar disa pika të errëta.

Në minutat që paraprinë epilogun tragjik, një numër njerëzish, për arsye të ndryshme, kanë qenë prezentë apo kanë arritur në vendin e ngjarjes.

Xhemail Smajli ishte duke punuar në pjesën e prapme të dyqanit të tij, një dyqan Fast-Food-i.

Burim Bajrami i përshkruan momentet në këtë mënyrë, gjatë seancës së zhvilluar më 12 shkurt 2009: Ai deklaroi se kishte qenë në rrugën "Tirana", përpara kafenesë "Prestigj" pak përpara orës 9, duke prititur ardhjen e ekskavatorit. Ai po pinte kafe dhe në tavolinën ngjitur me të ishin Vezir Bajrami, Kadri Bajrami dhe Hamdi Hasani. Ai hypi në ekskavator dhe e shkarkoi atë në rrugë. Ai e ka përshkruar pozicionin e tij duke deklaruar se ekskavatori kishte përballë lokalet "Cami" dhe se ai ishte paralel me lokalet "Cami" po të ishte në drejtim të Prizrenit, dhe se largësia mes ekskavatorit dhe lokalit "Cami" ishte afërsisht 4 metra.

Rifat Imeri, i cili është marrë në pyetje në të njëjtën ditë, as që arriti në vendin ku po shkonte (kafeneja “Prestigj”, për kafe) se të shtënat filluan rreth 10 deri në 15 metra përpara se ait ë arrinte në kafene, dhe se të shtënat po vinin nga ana a djathtë e tij.

Hamdi Hasani, gjatë së njëjtës seancë, dëshmoi se ditën në fjalë, dmth të shtunën, ai ishte ulur në kafene, ndërsa ajo po pastrohej, tavolina e tij ishte pranë një shtylle betoni. Pastaj ai takoi tani të ndjerin Dr. Vezir Bajrami dhe ata pinë kafe së bashku. Dr. Bajrami i kishte premtuar ta çonte në fshatin e tij, e ndërsa po bisedoni aty erdhi edhe Aziz Xhelili. Ai tha se kishte dëgjuar dy të shtëna dhe pastaj menjëherë edhe katër të shtëna të tjera që vinin nga jashtë dritares ku ishin ulur ata. Ai deklaroi se i kishte parë të pandehurit tek dritarja me armët e drejtuara drejt kafenesë, dhe kur ai ia kishte përmendur këtë fak Dr. Bajramit, ai ishte përgjigjur se lufta kishte përfunduar dhe se ai nuk besonte se ata do të qëllonin drejt tyre.

Kadri Bajrami është marrë në pyetje më datën 19 shkurt dhe ai ka përshkruar momentet që kanë çuar drejt incidentit. Ai ishte larguar nga shtëpia e tij në orën 08.30 në mëngjes, së bashku me Vezir Bajramin. Ai e kishte parë të pandehurin Hysni Gashi pranë stacionit të policisë. Kadri Bajrami dhe Vezir Bajrami po pinin kafe ndërsa po prisnin që të arrinte ekskavatori, i cili erdhi afërsisht në orën 09.30. Ai kishte ndihmuar që makineria të shkarkohej përtokë; Burim Bajrami ishte shoferi i ekskavatorit. Pasi ishte shkarkuar ekskavatori dhe kur Kadri Bajrami po tërhiqte anët, atëherë ndodhën të shtënat me breshëri nga drejtimi i ndërtesës “Cami”.

Dëshmitari **Fitim Ferati** deklaroi në dëshminë e tij se ai kishte qenë dëshmitar në kohën kur kishte arritur ekskavatori, ndërsa bisedonte me Besnikun, pasi e kishte pirë kafën ai ishte larguar nga kafeneja dhe pozicioni i tij ishte përballë ndërtesës “Cami”. Ai i dëgjoi të shtënat nga armët e zjarrit kur ishte shkarkuar ekskavatori.

Dëshmitari **Agni Musliu** deklaroi se ai kishte ecur nga vendi ku kishte parkuar makinën; pranë kafeneve “Prestigj” dhe “Margiona” ai ishte takuar me Dr. Vezir Bajramin. Dr. Bajrami e kishte ftuar të pinin kafe. Ata pinë kafe së bashku. Ai e kishte pyetur Dr. Bajramin se përse doktori kishte dalë në qytet të shtunën, meqë nuk ishte e zakonshme për doktorin. Dr. Vezir Bajrami u përgjigj se kishte ardhur të takonte vëllain e tij dhe punëtorët që ishin aty për të rrënuar ndërtesën. Pastaj ai ishte larguar nga kafeneja “Prestigj” dhe kishte shkuar në kafenenë “Marigona” të shihte nëse kishin arritur shokët e tij. Ai e kishte parë ekskavatorin të ngarkuar në një traktor, duke shtuar se ai kishte ndaluar përpara ndërtesës “Cami”. Ai deklaroi se kishte dëgjuar dy të shtëna armësh. Njëra ishte e drejtuar tek ekskavatori, dhe tjetra tek njerëzit.

Përsa i përket modaliteteve në të cilat ndodhën të shtënkat, disa gjëra janë të qarta, ndërsa të tjerat përmbajnë një shkallë paqartësie dhe konfuzioni të shkaktuar nga ndryshimet e versioneve të dhëna nga dëshmitarët.

Pra, është e pakundërshtueshme që zjarri u hap nga magazina (dyqani) e/i ndërtesës “Cami”, p.sh. vendi i cili ishte përdorur dhe ende përdorej si magazinë (dyqan) nga Feriz Gashi.

Gjithashtu mbetet e pakontestueshme se shënjestrat e qitësit ishin ekskavatori që sapo ishte shkarkuar nga maunia (kamioni) në asfaltin e rrugës “Tirana”, dhe klientët e kafenesë “Prestigj”.

Siç mund të shihet gjithashtu edhe nga fotografitë të cilat shoqërojnë raportin e policisë, dritaret e magazinës (dyqanit) ishin të mbuluara me gazeta, por kanatet e dritareve ishin pjesërisht të hapura.

Përsa i përket origjinës së të shtënave, deklaratat e dëshmitarëve janë të qarta. Sikurse është dëshmia e Agni Musliut (procesverbali i datës 19 shkurt 2009, faqe 29) që thote se ishin dy breshëri të shtënash me armë. Njëra prej tyre ishte e drejtuar nga ekskavatori, dhe tjetra ishte e drejtuar nga njerëzit. Ai dëshmoi se të shtënkat vinin nga ndërtesa e Camit. Ai tha se kishte dritare prej xhami dhe që ai kishte parë një armë automatike.

Dëshmitarët e tjerë (Fitim Ferati, Hamdi Hasani, Naser Tërshani) konfirmojnë që Vezir Bajrami dhe Aziz Xhelili u qëlluan ndërsa ishin ulur dhe nuk patën mundësi të largoheshin, sepse gjithçka ndodhi shumë shpejt.

Fitim Ferati shpjegon se të shtënkat e para goditën kolonat e ndërtesës ku gjendej kafeneja “Prestigj”, duke shkaktuar dëme (‘cifla’ është fjala e përdorur nga përkthyesi i Gjykatës) që e goditën në fytyrë.

Megjithatë, krijohet konfuzion në lidhje me numrin e qitësve.

Përsëri, Agni Musliu: *“Kishte dritare me xhama, dhe pastaj unë pashë një armë automatike që qëlloi në drejtim të ekskavatorit dhe një tjetër, që qëlloi në drejtim të njerëzve... Njëra nga armët automatike qëlloi në drejtim të ekskavatorit, dhe tjetra qëlloi në drejtim të njerëzve që ishin në kafenenë “Prestigj”.*

Në lidhje me këtë çështje, dëshmitari e ka përsëritur versionin e tij në mënyrë të pahezitueshme, edhe kur z. Fazli Balaj, me të drejtë vuri re: *“A mund t’i tregoni dëshmitarit se në dosjen e lëndës gjendet një raport balistike, i cili me qartësi thekson se 57 plumbat (më saktësisht, ‘predha’ apo ‘gëzhoja’ siç është qartësuar gjatë marrjes në pyetje së z. Lufti Raci, eksperti balistik – shënim i hartuesit të dokumentit) brenda ndërtesës “Cami” erdhën nga e njëjta armë automatike?”*

Me të vërtetë, dëshmitari ekspert Lufti Raci, konfirmoi se gëzhojat e armës me tytë të gjatë, që u gjendën në vendin e ngjarjes po vinin nga një armë e vetme, jo nga dy.

Dëshmitari ekspert, oficeri Lutfi Raci, dëshmoi se ishte një numër i përgjithshëm prej 57 plumbash që ishin qëlluar nga arma automatike e tipit 68. Asnjë plumb nuk ishte shtënë nga arma AK 47. Eksperti nuk mund të thoshte nëse arma AK 47 kishte qenë e pashkrepur, por ai konfirmoi se nuk kishte marrë ndonjë gëzhojë plumbi nga kjo armë për t'u ekzaminuar.

Edhe një dëshmitar tjetër i referohet një numri qitësish, nga 'ana e Gashëve'. Ky është dëshmitari Hamdi Hasani, në faqen 32, gjatë shqyrtimit kryesor, në seancën e datës 12 shkurt 2009, ku ai dëshmoi se nga qitësit ai kishte njohur Hysni Gashin dhe babain tij, ishin tre prej tyre dhe ata që të gjithë kishin armë. Ai deklaroi më tej se i pandehuri Feriz Gashi nuk ishte në shtëpi, por në ndërtesën "Cami".

...

Edhe Rifat Imeri, po ashtu, përmend prezencën e "*dy apo tri lloje armësh*" (seanca e datës 12.2.09, fq. 24), por, kur është pyetur në veçanti nga Prokurori, shpjegon: "*Unë vura re një mitraloz (p.sh. armë automatike me tytë të gjatë, shënim i gjyqtarit)*".

Breshëria e të shtënave filloi nga lokalet e okupuara nga familja Gashi, kjo është e qartë.

Kjo gjë provokoi reagimin e menjëhershëm të personave që ishin prezentë në vendin e ngjarjes.

Disa policë të panjohur, Burim Bajrami dhe Kadri Bajrami reagues ndaj sulmit.

Ndërhyrja e policëve gjatë të shtënave, (të paktën dy), për të mbrojtur rendin e qetësinë publike, si edhe pjesëmarrja e Burim dhe Kadri Bajrami, konfirmohen nga burime të ndryshme.

Përsa i përket veprimit nga ana e policisë, ka disa dëshmi të dëshmitarëve; përsa i përket Burim dhe Kadri Bajramit, ka një njohje të hapur në Gjykatë, një rrëfim të hapur në Gjykatë, në lidhje me kapjen dhe përdorimin e armëve, (që kishte çuar në procedurë të veçanta, në dënimin e tyre, meqë paraburgimi kishte qenë i paligjshëm).

Në versionin e avokatëve mbrojtës, kanë ndërhyrë edhe persona të tjerë të pidentifikuar.

Prezanca e personave të tjerë të pidentifikuar, edhe nëse nuk përjashtohet tërësisht, konfirmohet paksa.

Asnjë dëshmitar nuk konfirmon nëse dikush (përveç Burim dhe Kadri Bajramit) mori anën e familjes Bajrami, duke shtënë.

Po ashtu, edhe gjatë raportit balistik, është e vështirë të gjenden elementë të fuqishëm për të mbështetur presupozimin e mbrojtjes.

Dëshmitari ekspert, Lutfi Raci, në përmbledhjen e bërë në Gjykatë mbi raportin, ka shpjeguar se ai kishte marrë katër armë për analiza, së bashku me një numër të qartë të gëzhgojave, predhave (të quajtura gjithashtu edhe gëzhoja), plumbave dhe fragmenteve të tyre. Por ai ka shpjeguar më tej, (në seancën e datës 4 mars 2009, fq. 20) se, nga analizat e bëra të predhave dhe pjesëve të tyre të cilat i janë dorëzuar atij, ka dalë se janë përdorur të paktën 6 armë gjatë incidentit të të shtënave. Dhe ai ka shpjeguar më tej, se një armë (AK 47, arma automatike e sekuestruar në makinën Opel, me të cilën kishte arritur në vendin e ngjarjes Burim Bajrami), nuk ishte përdorur gjatë incidentit, (sigurisht, ajo ishte nxjerrë nga bagazhi i makinës vetëm pasi kishin përfunduar të shtënat).

Nga të katër armët e dorëzuara për analiza, asnjëra prej tyre nuk ishte për përdorim zyrtar, pra, asnjëra nuk ishte përdorur nga oficerët e policisë. Njëra (AK 47) nuk ka qëlluar sepse ka qenë në bagazhin e makinës së Burim Bajramit. Nga të tri armët e tjera që mbetën, njëra ishte e Tipit 68 dhe dy të tjerat ishin pistoleta. Arma e Tipit 68 është përdorur nga një person i familjes Gashi, ndërsa pistoletat, është e lehtë të arrish në përfundimin se janë përdorur nga Burim dhe Kadri Bajrami.

Është e vërtetë se nga analizat e predhave dhe pjesëve të tyre, dëshmitari ekspert kishte arritur në përfundimin se ishte qëlluar nga gjashtë armë, por kjo mund të ketë një mori shpjegimesh.

Së pari, mund të ketë qenë edhe një oficer tjetër policie, meqë kishte edhe një numër oficerësh policie në vendngjarje (8).

Së dyti, nuk është e mundur të përcaktohet se në cilën anë po qëndronte qitësi i panjohur. Me fjalë të tjera, mund të debatohet se ka qëlluar më shumë sesa një person nga familja Gashi.

Sidoqoftë, kjo është një çështje me pak rëndësi, meqë nuk e ndryshon në mënyrë të konsiderueshme përfaqësimin e ngjarjeve që kanë dalë nga mbledhja e provave dhe që veçojnë një shkëmbim zjarri, në të cilin ishin të përfshirë disa persona.

Për më tepër, panorama e ngjarjeve që zhvillohen i hedh poshtë të dyja versionet kryesore të mbrojtjes.

Në të vërtetë, përse i përket zhvillimit dhe modaliteteve të breshërive të të shtënave, janë sugjeruar dy çështje nga avokatët mbrojtës, në favor të të akuzuarve.

E para, thotë se fillimisht ka pasur një të shtënë të vetme paralajmëruese, ose disa të shtëna të largëta, që janë qëlluar nga magazina (dyqani) Cami në drejtim të ajrit, me qëllim që të shpërndareshin njerëzit që ishin mbledhur dhe të ndalohej ekskavatori, në një përpjekje që të shmangeshin problemet përpara se ato të shtoheshin. Por,

vazhdohet argumenti, disa të shtëna shkaktuan një reagim disproporcional nga anëtarët e familjes Bajrami, dhe që të gjithë erdhën në vendin e ngjarjes tërësisht të armatosur. Ajo që ndodhi më pas – është përfundimi i debatit- nuk ishte parashikuar, sigurisht që nuk pritej, dhe ishte shumë pak e dëshiruar nga familja Gashi.

Argumenti i dytë fillon që me vëzhgimin se të dyja familjet, Ferati dhe Bajrami, po mbledheshin në qendër të qytetit të armatosur. Kjo do të thotë se ata, të dyja palët, ishin gati të luftonin, të ndërjegjeshëm për pasojat e mundshme. Prandaj, moralisht debatohet, se grupi Bajrami-Ferati dhe familja Gashi ishin në të njëjtin nivel dhe se ata duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Të dyja argumentet nuk janë të bazuara dhe nuk janë të pranueshme.

I pari, (një reagim disproporcional i së shtënës paralajmëruese), nuk mbështetet nga dëshmitë, të cilat, në kor, i referohen një sekuence fillestare të pandërprerë të shtënash, (me *nuanca* të ndryshme) dhe jo të shtënave të veçanta. Dëshmitari (Hamdi Hasani) i referohet gjashtë të shtënave fillestare që kishin për qëllim të menjëhershëm i të cilave, nuk ishte për të paralajmëruar, por për të kapur në befasi Vezir Bajramin, i cili me të vërtetë u qëllua që me të shtënat e para. Për më tepër, nuk mund të kuptohet se si të shtënat paralajmëruese në drejtim të ajrit mund të qëllohen që nga brenda magazinës (dyqanit): fotografitë që shoqërojnë Raportin e Policisë tregojnë qartësisht se kjo mundësi është praktikisht e pamundur për prezencën e parahyrjes përpara magazinës (dyqanit). Për më tepër, përse të qëllohet, kur mund të merret fare mirë me mend, për arsye të së shkuarës së palëve, se kjo mund të ketë shkaktuar një reagim të ashpër?

Argumenti i dytë (të dyja grupet/familjet ishin gati për të luftuar, e kështu që moralisht ato janë në të njëjtin nivel) nuk është realist dhe, sidoqoftë, nuk na çon diku.

Nuk është realist, sepse nuk është i vërtetë: nëse mund të pranohet që disa nga pjesëtarët e familjes Bajrami iu afruan vendit të ngjarjes dhe u përgatitën që të përballëshin me një farë lloj rezistence nga familja që kishte okupuar ndërtesën që do të rrënohej, kjo nuk do të thotë që ata mund të merrnin me mend madhësinë e vërtetë të konfliktit që do të ndodhte, dhe aq më pak faktin që ata kishin planifikuar një aksion të armatosur. Përndryshe, Burim Bajrami nuk do ta kishte lënë AK 47 në bagazhin e makinës dhe anëtarët e familjes nuk do të ishin mbledhur në mënyrë paqësore në kafenenë “Prestigj” për të pirë kafe duke pritur për ekskavatorin. Për më tepër, edhe nëse provohet (gjë që nuk ndodh) ky argument nuk do ta sjellë Gjykatën në përfundimin e sugjeruar nga avokatët mbrojtës, p.sh. që *in bello* (Latinisht për ‘në rast lufte/konflikti’) nivelet e ndryshme të përgjegjësisë nuk mund të identifikohen dhe se të gjithë ata që përfshihen do t’i nënshtrohen të njëjtit vlerësimi moral. Ky është një përfundim që nuk mund të ndahet në përgjithësi, dhe që, sigurisht, nuk mund të aplikohet në çështjen në fjalë.

Reagimi i Burim dhe Kadri Bajramit ishte thjeshtë vetë-mbrojtje, që quhet 'mbrojtje e nevojshme' nga Kodi Penal i Kosovës dhe që parashikohet me anë të Nenit 8.

Përsa i përket mbrojtjes së nevojshme, reagimi i kishte të gjitha tiparet:

- 1) ekzistonte nevoja 'për të shmangur një sulm të paligjshëm, real dhe të pashmangshëm': sulmi nga magazina (dyqani) 'Cami' nuk ishte i justifikuar apo i ligjshëm; nuk ishte spekulativ apo imagjinar, sulmi ishte diçka kaotike në lidhje me ekskavatorin dhe klientët e kafenesë dhe kishte fuqi të madhe shkatërruese mbi gjithçka/çdokënd që ishte brenda rrezes së veprimit të zjarrit; pashmangshmëria nënkupton sinkronizim, apo në më të shumtën afërsinë/përafërsinë në kohë, e cila ka ekzistuar, meqë reagimi ka pasuar menjëherë veprimin, për ta ndërprerë atë dhe për të parandaluar të shtënat e mëtejshme.
- 2) 'nga vetë personi ... apo ndonjë person tjetër': nuk ishte e mjaftueshme për Burim dhe Kadri Bajramin të përpiqeshin të largoheshin apo të fshiheshin: pjesëtarë të tjerë të familjes po sulmoheshin dhe duheshin mbrojtur. Nevoja për të ndaluar sulmin nuk ishte një nevojë personale, ishte një kërkesë e një grupi të zgjeruar njerëzish.
- 3) proporcionaliteti: standarti sigurisht që respektohet. Të gjendur në vendin e ngjarjes nga zjarri i një arme automatike që kishte përfshirë rrugën, Burim dhe Kadri Bajrami ishin brenda rrezes së proporcionit duke reaguar me pistoletat që i kishin me vete.

Burim dhe Kadri Bajrami vepruan në vetë-mbrojtje. Çfarë mund të kishin bërë tjetër ata? Të prisnin sa të qëlloheshin, siç kishte ndodhur me dy viktimat?

Reagimi i tyre nuk ishte kriminal në natyrën e tij, sepse asnjë profil nuk mund të 'kompensojë' apo të 'pakësojë' veprimin që e kishte shkaktuar atë.

Edhe po të prananim se reagimi i Burim dhe Kadri Bajramit ishte i paligjshëm (që nuk ishte), përfundimi nuk do të ndryshonte: një reagim i paligjshëm nuk e bën veprimin e paligjshëm që e shkakton atë të ligjshëm, në të njëjtën mënyrë sipas së cilës një gabim nuk mund të çbëhet me anë të një gabimi tjetër.

Për të përfunduar, asnjë nga justifikimet e ofruara të avokatëve mbrojtës për t'u marrë në konsideratë nga Gjykata, nuk qëndron.

Pas shqyrtimit të provave që lidhen me breshërinë e të shtënave, tani ka ardhur koha të kthehemi tek çështja kyçe e përgjegjësisë për ta shkaktuar atë, p.sh. tek identifikimi i përgjegjësië.

Gjykata vëren se përcaktimi i përgjegjësisë së dy të akuzuarve kërkon nevojën e aplikimit të standarteve të ndryshme të vlerësimit.

Nga njëra anë, ekziston akuza e ngritur kundër Feriz Gashit, për një veprë penale që ka ndodhur, që të themi, *en plein air*, pa ndonjë përpjekje apo paralajmërim për të fshehur apo për të mbrojtur, thjeshtë në prezencën e njerëzve, shumica e të cilëve ishin oficerë policie të përfshirë në detyrë zyrtare.

Nga ana tjetër, akuza kundër Hysni Gashit është në lidhje me një veprim fillimi apo nxitjeje, të një veprimtarie që ka një manifestim të jashtëm.

Duke filluar nga Feriz Gashi, vlen të vihet re se që në fillim dyshimi kryesor u përqëndrua tek ai: ai ishte djali më i madh, i vetmi që kishte një interes specifik, personal në ruajtjen e dyqanit (të përdorur gjithashtu edhe si magazinë), natyrisht i afërt me Hysni Gashin, që kishte edhe interesin primar në padinë civile, me qëllim që të absorbonte dhe të vuante zhgënjimet që vinin nga ndjesia e tij e pafuqishmërisë ndaj një situatë të pafavorshme, të cilën e kishte të pamundur ta vinte nën kontroll.

Kush tjetër mund të ishte i dyshuari kryesor? Babai? Ai ishte mjaft i vjetër për një hakmarrje të tillë të përgjakshme, mjaft i ftohtë dhe tepër inteligjent për modalitetet brutale e të pasofistikuar të ekzekutimit të veprës penale.

Ndonjë kushëri i Ferizit, apo vëlla i Hysniut? Ky person ishte tepër larg nga inetersat në fjalë, për të pasur një përfshirje të drejtëpërdrejtë të kësaj madhësie.

Kush tjetër?

Dhe në të vërtetë, të gjithë elementët e provave drejtohen nga përgjegjësia e Ferizit. Këta elementë janë si më poshtë vijon:

- 1) vetë rrëfimi i të akuzuarit. Feriz Gashi, për arsye personale, ka zgjedhur të mbrohej në heshtje gjatë marrjes në pyetje në Gjykatë. Duke pasur frikë nga reagime të mundshme, ai nuk pranoi t'u përgjigjej pyetjeve të Prokurorit. Kjo nuk ndikon mbi deklaratat që ai ka dhënë më parë. E drejta e mbrojtjes në heshtje është një privilegj që i jepet të akuzuarit për arsye të dukshme (*nemo tenetur se detegere*) por pasi jepet një deklaratë, me garancitë e siguruara me anë të ligjit, zgjedhja e mëpastajme për të mos folur (në Gjykatë apo në ndonjë vend tjetër) nuk rezulton në revokimin e deklaratës së mëparshme.

Neni 156 i KPPK parasheh që deklaratat që i pandehuri u jep autoriteteve hetimore është e provë e pranueshme në gjykatë, nëse është marrë në mënyrë të ligjshme. Në çështjen në fjalë, nuk ka ndonjë pyetje në lidhje me ligjshmërinë e deklaratave, ku janë respektuar të gjitha rregullat. Nga avokati mbrojtës i Feriz Gashit, apo nga vetë i pandehuri nuk është ngritur asnjë kundërshtim.

Përveç ritualit të deklaratave, dispozita (Neni 156 KPPK) nuk vendos asnjë kufizim në lidhje me përdorimin e deklaratave të të akuzuarit, dhe për atë për të cilën bëhet fjalë tani, nuk e ndalon përdorimin e tyre në rast se i akuzuari zgjedh që të qëndrojë në heshtje gjatë fazës së gjykimit kryesor. Me fjalë të tjera, për rastin që po shqyrtojmë, (ku i akuzuari deklaroi se do të qëndrojë në heshtje gjatë fazës së gjykimit kryesor), nuk ekziston ndonjë rregull i ngjashëm me atë që

përcaktohet në Nenin 368 KPPK, për të pandehurin, i cili gjatë fazës së gjykimit kryesor refuzon të flasë.

Neni 368 KPPK siguron një mekanizëm në rast se një dëshmitar ‘refuzon të dëshmojë në gjykimin kryesor pa pasur arsye të ligjshme’; në këtë situatë, normat përcaktojnë që “proçesverbalit/-et që përmbajnë dëshminë e dëshmitarit/-ëve mund të lexohen në bazë të një vendimi të trupit gjykues”.

Kuptohet që ky mekanizëm nuk vlen për rastet kur dëshmitari përjashtohet nga detyra për të dëshmuar (p.sh. ish neni 160 KPPK), p.sh. kur ai ka një privilegj.

Nuk ka asnjë dispozitë analoge për rastin e deklaratave të të akuzuarit, i cili dëshiron të qëndrojë në heshtje gjatë gjykimit kryesor.

Kur një situatë nuk rregullohet në mënyrë të veçantë, mendimi ligjor njih vetëm dy rregulla për të mbushur *lacuna legis*: analogjinë (*ubi eadem legis ratio, ibi eadem legis dispositio*) apo argumentin *a contrariis* (*ubi lex voluit dixit, ubi noluit, taquit*).

Tashmë, ngjashmëria, siç është thënë, është vetëm e dukshme, dhe rrjedhimisht, kufizimi që vendoset me anë të Neni 368 të KPPK, në lidhje me përdorimin e provave të mbledhura përpara gjykimit nuk duhet të aplikohet me anë të analogjisë në lidhje me deklaratën që i pandehuri ka dhënë përpara policisë, apo prokurorit gjatë proçesit të hetimit. Pozicioni i të pandehurit është i ndryshëm nga ai i dëshmitarit. i dyshuari, edhe gjatë fazës hetimore, ndihmohet nga një avokat, dhe që të flasim qartë, nuk është subjekt i marrjes në pyetje nga pala kundërshtare, meqë ai nuk është asnjëherë i detyruar të tregojë të vërtetën apo të përgjigjet. Ai ka një mundësi të pakufizuar të qëndrojë në heshtje, ndërsa dëshmitari ka një detyrë të përgjithshme të flasë dhe përjashtimet në rastin e dëshmitarit janë të jashtëzakonshme. Në përgjithësi, është një pozicion krejt tjetër, që nuk lejon gjetjen e kushteve përt të aplikuar analogjinë.

Së fundmi, Gjykata beson se Neni 156 KPPK jep justifikime të mjaftueshme ligjore për përdorimin e deklaratave të të akuzuarit si prova, edhe po qe se ato nuk konfirmohen nga i pandehuri, i cili gjatë gjykimit kryesor preferoi të qëndronte në heshtje.

Më 10 maj 2005 i pandehuri Feriz Gashi është marrë në pyetje nga Prokurori Publik, Lulëzim Sylejmani. Ai deklaroi se pasi e kishte parë ekskavatorin të shkarkohej në tokë, ai kishte hyrë në shtëpinë e tij dhe kishte marrë armën AK-47 nga dhoma e tij. Ai kishte hyrë në ndërtesën “Cami”, me dy (2) karikatorë duke mbajtur edhe 30 e 25 plumba, ai pranon gjithashtu se ai kishte në pronësi tri (3) granata dore. Ai pranon të ketë qëlluar një breshëri zjarri, 5-6 të shtëna, nga dritarja e ndërtesës “Cami”. Ai vazhdon të dëshmojë se zjarrit të tij i ishte përgjigjur me zjarr nga ana tjetër. Duke u përballur me zjarr ai ishte kundërpërgjigjur duke shtënë edhe më tepër. Ai kishte frikë se ata do të vinin e do të hynin në ndërtesën “Cami” dhe në shtëpinë e tij. Ai përshkruan se e kishte parë

të ndjerin Vezir Bajrami me një armë në dorë, e kishte parë Kadri Bajramin dhe shoferin e ekskavatorit (Burim Bajramin) me armë duke qëlluar në drejtim të tij, e kishte parë gjithashtu të ndjerin Aziz Xhelili, por ai nuk kishte armë. Kur i mbaruan municionet, dhe ai pa që këta persona po i afroreshin më shumë pozicionit të tij, ai hodhi granatën e dorës, por granata nuk shpërtheu. Pasta jai mbushi përsëri armën dhe qëlloi përsëri me një breshëri të shtënash në drejtim të sulmuesve derisa i mbaruan municionet, ai e pranon se nuk e di se kë qëlluan plumbat e tij. Në këtë fazë, ai tenton të hedhë granatën e dytë të dorës, e cila përsëri nuk shpërtheu. Megjithatë, në këtë moment, babai i tij, i pandehuri Hysni Gashi, del jashtë dhe e qorton atë. Granata e tretë nuk u përdor. Këto municione ishin mbajtur nga lufta, si kujtime. Ai vazhdon duke thënë se pasojat e rënda të të shtënave, duke përfshirë vdekjet dhe lëndimet, i kishte marrë vesh në stacionin e policisë. Ai deklaroi se asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk ishin të implikuar në këtë incident.

Deklaratat e Feriz Gashit përpara gjykimit kryesor, p.sh. gjatë zhvillimit të hetimeve, janë në pjesën më të madhe rrëfyese dhe edhe nëse janë vetë-akuzime, ato janë të shoqëruara nga përpjekje naive për t'u justifikuar (duke thënë se ai qëlloi në ajër dhe se anëtarët e familjes Bajrami po afroreshin dhe se në atë kohë ai kishte frikë prej tyre), prezenca e të akuzuarit në dyqanin (magazinën) "Cami" dhe gjatë të shtënave përcaktohet në mënyrë të pakundërshtueshme.

- 2) Dëshmia e dëshmitarit Hamdi Hasani, e përmendur më sipër, e cila ka identifikuar Feriz Gashin tek '*Lokalet e Kadriut*' (p.sh. ndërtesa që ishte në pronësi të Kadriut e që do të rrënohej, e që do të thotë dyaqni –magazina 'Cami') menjëherë përpara të shtënave.
- 3) Deklarimet e Hysni Gashit mbi këtë çështje. Gjatë marrjes në pyetje, kur është pyetur në lidhje me pjesëmarrjen e djalit të tij gjatë të shtënave, Hysni Gashi ka shmangur me kujdes përmendjen e Ferizit si autori i të shtënave, madje edhe kur është pyetur në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ai ishte në gjendje të shmangej, duke e injoruar pyetjen apo duke ndërruar fjalët.
Megjithatë, gjatë përfundimit të marrjes në pyetje, ai përshkroi çfarë kishte bërë kur kishte dëgjuar të shtënën, duke shpjeguar se doli nga shtëpia e tij, shkoi në kopësht, në drejtimin prej nga vinin të shtënën, u takua me djalin e tij, që po vinte nga drejtimi i dyqanit me një armë automatike në dorë. Dhe në atë moment, ai tha, se ia mori armën nga duart të birit dhe, kur u pyet nga kryetari i trupit gjykues nëse arma ishte e ngrohtë, ai u përgjigj se ajo ishte shumë e ngrohtë, sikur të digjte. Ky detaj duket se është përfundimtar në lidhje me pohimin e përgjegjësishë së Feriz Gashit. Me një shprehje të njohur në zhargonin ligjor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe atyre të Vendeve Anglo-Saksone, me të vërtetë mund të thuhet se Feriz Gashi u kap me '*presh në duar*'*.

Siç thuhet edhe më sipër, vlerësimi i përgjegjësisë së Hysni Gashit kërkon një arsyetim të veçantë.

Ai akuzohet se ka nxitur djalin e tij për të kryer atë që faktikisht ka kryer Ferizi, p.sh. të parandalojë me çdo kusht, madje edhe me anë të përdorimit të dhunës, dhe vdekjes ndonjë tentativë për të marrë pronësinë e lokaleve që ishin okupuar (në mënyrë abuzive) që prej shumë vjetësh nga ai (Hysni), dhe ndonjë anëtar tjetër i familjes së tij.

Neni 24 KPPK, që përcakton parametrin për sanksionimin e nxitjes, nuk jep ndonjë përkufizim të saj. Rrjedhimisht, është paraprakisht e nevojshme të kuptohet se çfarë koncepti ekziston pas kësaj fjale.

Nxitja mund të përkufizohet si një veprimtari që drejtohet për të bindur dikë të ndërmarrë një veprim, të veprojë. Në kuptimin pozitiv, mund të përfshijë, për shembull, një inkurajim që i jepet një atleti nga një tifoz apo ndonjë skuadër, në mënyrë që ata të bëjnë përpjekjet maksimale gjatë një momenti kryesor në ndeshje apo garë, duke ua shtuar atyre kurajon dhe një ndjenje përkatësie e besimi, me qëllim që të ngrenë ndjenjën e krenarisë dhe dinjitetit që e ndihmon atletin të luajë me më shumë trimëri. Në një kuptim më pak pozitiv, fjala përdoret për të përshkruar veprimin e një udhëheqësi politik kur i drejtohet turmës me fjalime retorike dhe inflamatore për t'u hedhur në revoltë apo për të kaluar nga protestat e përgjithshme në rrugë, tek dhuna.

Në të dyja situatat e përshkruara më sipër, personi që nxit, me anë të veprimit të tij, përpiqet të arrijë diçka, të bëjë diçka që ai vetë, vetëm, nuk do të ishte kurrë në gjendje ta bënte, për arsye të pamjaftueshmërisë fizike (në ngjarjen e sportit), apo në lidhje me një grup të vogël (revolta është veprimtari që kryhet në grup).

Për më tepër, kushti për nxitjen është ekzistenca e lidhjes morale dhe psikologjike mes nxitësit dhe personit të nxitur, që i jep të parit bindjen (në nivelin e njohurive racionale apo me anë të intuitës së thjeshtë) që fjalët e tij do të ndiqen. Që të ndodhë kjo, nxitësi dhe personi i nxitur duhet të kenë të njëjtën prejardhje kulturore, të kenë të njëjtën prejardhje kulturore, të kenë të njëjtat vlera morale apo të njëjtat interesa; ata duhet të kujdesen për të njëjtën gjë. Qoftë kjo në lidhje me flamurin e një skuadër futbolli, nderin e familjes, apo etja për liri, drejtësi, apo, në formë më prozaike, për kushte më të mira jetese, nëse nxitja nuk merret parasysh, nëse mungon ndjenja e përkatësisë ndaj së njëjtit kusht, nxitja shmanget dhe ajo është qesharake, si ato fjalët që mund t'i fliten një muri. Për këtë arsye, fjalimet nxitëse shpesh i referohen retorikës, apo më mirë, imazheve simbolike, të cilat janë të drejtuara kryesisht drejt zemrës së individit apo turmës, më tepër se sa të bëhen pjesë racionale e saj.

****Shënim i përkthyeses: Shprehja e përdorur në kuptimin e padiskutueshëm të provës.***

Gjithashtu, një përkufizim ligjor i nxitjes i përfshin këta elementë, që kanë të bëjnë me fjalën kryesore, apo stimulim për të kryer një veprë penale. Gjithashtu, në fushën penale, kërkohet edhe varësia morale, si edhe identiteti i interesave dhe prejardhjes kulturore mes personit që nxit dhe personit që nxitet.

Pra, Hysni Gashi akuzohet se e ka nxitur djalin e tij të kryejë veprat penale të specifikuara në akuzat kundër Feriz Gashit.

Me qëllim që të kuptohen akuzat, ekziston nevoja për të marrë në konsideratë disa çështje paraprake.

Do të ishte naëve të mendohej se nxitja mund të provohet vetëm përmes dëshmisë apo dokumenteve. Nxitja për të kryer një veprë penale, ka të bëjë kryesisht me një lloj stimuli që nuk bëhet kurrë përpara publikut. Vetëm nëse ajo ka të bëjë me ndonjë fjalim inflamator që drejtohet ndaj një grupi njerëzish (për shembull të sulmohet një stacion policie apo të sulmohet Parlamenti i një Vendi), gjë që mund të merret pak me mend, që nxitja shprehet në publik: në të njëjtën mënyrë si marrëveshja për të kryer një veprë penale, e cila pothuajse asnjëherë nuk u bëhet e ditur të tjerëve (kush i planifikon veprat penale në publik?), nxitja kalon drejtëpërdrejtë nga personi që e shpreh atë, tek personi që e merr atë. Saktësisht sepse ajo kalon nga një autoritet më i lartë moral tek një autoritet më inferior, nga frymëzuesi tek ekzekutuesi, personi i parë do të përdorë kujdes në dhënien e urdhrin të turpshëm personit të dytë.

Në të gjitha rastet kur nxitja bëhet nga një individ dhe drejtohet kundër një individi të vetëm, ashtu si edhe rasti që përshkruhet në akuzat, ku presupozohet se Hysni Gashi e ka nxitur djalin e tij, Feriz Gashi, nuk ka mundësi praktike që të gjendet një dëshmitar për të konfirmuar se është dhënë urdhri, dhe nuk ka as dokumente që të përmbajnë urdhrin për vrasjen. Ne mendojmë se askush nuk është aq budalla, apo naiv, që të lejojë që të tjerët të dinë se ai po planifikon një veprë penale, e madje, edhe më keq, që ai do ta kryejë atë përmes një personi tjetër, meqë ai nuk e ka kurajon, guxim për ta bërë atë vetë.

Ç'duhet bërë, atëherë? A duhet që Gjykata, në mungesë të dëshmitarëve të refuzojë të vlerësojë ekzistencën e një nxitjeje? A duhet që kërkesa për drejtësi që vjen nga viktimat që përbëjnë shoqërinë, të hidhet poshtë, thjeshtë sepse askush nuk ka dëgjuar që të jepet urdhri vrasës, që është i qartë?

Gjykata mendon se zgjidhja do të jetë një mënyrë për t'iu shmangur pjesës më të madhe të rasteve, aty ku marrëdhënia e ngushtë mes frymëzuesit dhe të frymëzuarit e parandalon mundësinë për të ditur me saktësi shkëmbimin e fjalëve mes dy personave.

Përfundimi nuk do të jetë i pranueshëm: të njëjtat rregulla të thyera (të natyrës kulturore: kuptimi i tejkualuar i nderit, vlera e pronës mbi jetën, bindja jo kritike ndaj kreut të familjes, detyra për të kryer çdo urdher të dhënë, pa pasur parasysh nëse ai

është i një natyre kriminale) që e lejojnë frymëzuesin të vendosë njërin nga anëtarët e familjes të kryejë veprën penale, do ta ruajë atë (frymëzuesin) nga përgjegjësia penale. Në të vërtetë, kodet e përmendura të sjelljes vendosin tek personi inferior gjithashtu edhe një kuptim të pamoralshëm devotshmërie që e detyron ekzekutuesin të sakrifikojë i vetëm, të mbrojë babain, t'i garantojë imunitet personit që e ka dhënë urdhrin.

Kjo nuk është çështje paragjykimi ndaj të akuzuarit; vetëm se kërkohet një përqasje më e sofistikuar në lidhje me vlerësimin e provave. Një përqasje që lejon që ngjarjet të mos mbështeten thjeshtë në deklaratën e drejtëpërdrejtë të dëshmitarit, apo në leximin e një dokumenti, por në analizën e të gjitha provave materiale që i vihen në dispozicion Gjykatës.

Përsa i përket kësaj, për aktgjykimin janë të rëndësishëm elementët e mëposhtëm:

- 1) Përshkrimet e gjata gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore të mosmarrëveshjeve që e kanë ekspozuar familjen Gashi në njërin anë dhe familjen Bajrami-Ferati në anën tjetër, të cilat në përgjithësi e kanë përjashtuar Feriz Gashin. Me përjashtimin e një rasti të vetëm (në ditët përpara ngjarjes fatale), Feriz Gashi nuk është lejuar të marrë pjesë në takimet dhe pazaret, të cilat u përpoqën më kot ta zgjidhin konfliktin në mënyrë paqësore. Nëpër takime mund të kenë marrë pjesë disa njerëz më të vjetër (shprehje kjo që është përdorur shpesh), anëtarë të respektuar të komunitetit, si ndërmjetës, por jo djali. Edhe babai i Ferizit, Hysniu, është përpjekur ta theksojë këtë shpesh, gjatë marrjes në pyetje të datës 24 mars, që djali i tij nuk kishte ndonjë peshë në ato biseda, dhe se ai (Hysniu) nuk e kishte përfshirë atë (Ferizin) në mosmarrëveshje, meqë ai (Hysniu) ishte kryetari i familjes. Në rast se ka ndodhur kështu (ashtu siç mendon edhe Gjykata që ka ndodhur) arsyet për veprimin vrasës të Ferizit janë të pakuptueshme, nëse nuk pranohet që Hysniu e ka informuar djalin e tij në lidhje me zhvillimet më të fundit, ditën para ditës kritike, disa ditë më parë, duke i komunikuar atij që pavarësisht nga përpjekjet e gjata të tij (Hysniut) për të mbajtur pronësinë mbi tokën dhe dyqanin, ndërtesa do të rrënohej dhe toka do t'i dorëzohej grupit opozitar të nesërmen. Por, nëse Ferizi ka qenë i përjashtuar vazhdimisht deri atëherë, nëse ai nuk ka qenë kurrë i përfshirë deri në momentin e fundit, përse duhet të kishte dalë në skenë ai në atë moment? Nuk ekziston një histori e irritimit progresiv të Ferizit, i dëshpërimit për humbjen e dyqanit të tij, apo i dëshpërimit të turpërimit të familjes së tij; askush nuk i referohet treguesve të përfshirjes së mëparshme të djalit në punët e të atit, të pjesëmarrjes psikologjike në vuajtjen e familjes në lidhje me dëbimin nga prona. Në këto kushte, a është e pranueshme që ai e mori iniciativën pa lejen e duhur nga babai i tij? Ferizi (duke ndjekur mësimet tradicionale shqiptare) kishte pranuar deri atëherë të jetonte në të njëjtën shtëpi me babain e tij, kishte pranuar një farë lloji autonomie të minimizuar në të gjitha vendimet në lidhje me familjen e tij dhe detyrat e tij ndaj familjes. A nuk është e pabesueshme që, në prag të ditës kritike, ai e ndryshon tërësisht personalitetin e tij dhe vendos në mënyrë të pavarur të zgjidhë një mosmarrëveshje që në fakt i takon babait të tij për ta zgjidhur, pa mbështetjen morale të personit që deri atëherë

kishte autoritetin suprem? Në fund të ditës, fakti që ai nuk është dënuar më parë, rrethana që deri ditën përpara ngjarjes ai ishte një njeri i thjeshtë, një qytetar i respektuar me një profesion të thjeshtë, dhe të nesërmen ai ishte një vrasës brutal, tregon diçka mbi personalitetin e tij, pamundësinë për t'i rezistuar një presioni psikologjik me të cilin ai nuk ishte mësuar, pamundësinë e tij të racionalizonte një situatë mbytëse me të cilën ai nuk mund të përballej.

- 2) Argumenti që i paraprin ngjarjes i hap rrugë tjetrës. Është një argument *a contrariis*, që bazohet mbi një konsideratë logjike. Duke u nisur që nga vëzhgimi se në çdo aspekt të jetës së familjes, babai (Hysniu) ishte autoriteti i padiskutueshëm dhe se ai ishte qendra e të gjitha interesave dhe vendimeve, nuk është e mundur të gjendet një justifikim racional mbi atë që ka ndodhur nëse ne mendërisht e largojmë prezencën dhe rolin e Hysniut nga ngjarjet (duke e hequr atë edhe nga ngjarja e fundit, p.sh. vepra penale). Përse të vrasësh, për interesat e kujt? A mund të mendohet që në mënyrë spontane Ferizi vret, në emër të dikujt tjetër? Është mjaft e qartë që Ferizi vret për të mbrojtur interesat dhe nderin e familjes, e kështu, të përfaqësuesit supreme të familjes, babait të tij. Ai nuk vret për të mbrojtur interesat e tij (hakmarrja për rrënimin e dyqanit të tij), të paktën kjo nuk ishte arsyeja kryesore. Ky proces (në termat psikoanalitike, një *transferim*, sipas interpretimit klasik Frojdian) nuk mund të kishte ndodhur pa mbështetjen dhe nxitjen e Hysniut, interesat e të cilit, si përfundim, donte të kënaqte dhe t'u shërbente Ferizi. Nëse Hysniu, personaliteti dhe roli i tij në familje largohet dhe nënvlerësohet, vepra penale nuk ka një motiv të mjaftueshëm, një bazë racionale apo emocionale.
- 3) Burim Bajrami, Hamdi Hasani dhe dëshmitarët e tjerë kanë konfirmuar (dhe Hysniu nuk e ka mohuar të njëjtën rrethanë) episodin që ka ndodhur në klinikën e Vezir Bajramit, gjatë së cilit Hysniu e ka kërcënuar viktimën me fjalët (Burim Bajrami, seanca e datës 12.2.09) : “Kam hapur dy varre që janë gati e po presin. Njëri është për ty dhe tjetri është për dikë nga familja Ferati”. Kërcënime analoge ndaj atyre që po përpiqeshin të ekzekutonin vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajit, janë shprehur nga i njëjti i akuzuar (Hysniu) ndaj Rifat Imerit, kur ky i fundit kishte shkuar në dyaqin e tij (të Hysniut) për të rregulluar një copë. Këto kërcënime nuk ishin shprehje të përgjithshme të zhgënjimit apo zemërimit, por në fakt ato ishin manifestime të një vendimi që tashmë ishte marrë, e që ishte përçarur tek djali i tij.
- 4) Faktori kulturor. Kjo çështje është debatuar mjaft gjatë fjalëve përfundimtare dhe përpara tyre. Debati filloi duke vënë re se familja tradicionale në Kosovë bazohet në një përqëndrim të theksuar pushteti në duart e kreut të familjes. Debati u zhvillua duke marrë në konsideratë se është themelore në detyrat e fëmijës mashkull të respektojë plotësisht autoritetin e babait dhe të mbrojë interesat dhe nderin e familjes, të cilat i atribuohen ekskluzivisht babait. Nga kjo rrjedh, që argumenti çohet më tej, me anë të urdhrave të qartë apo thjeshtë ‘me sy’, është e mundur të jepen urdhra të cilat nuk mund të kundërshtohen. Thuhet se ky është një tipar i shoqërisë shqiptare, në Kosovë apo Shqipëri, i cili garanton devocionin

e vlerave të familjes, ndërkohë që mbrohet individi si pjesë e familjes. Përmes bindjes së plotë ndaj këtyre rregullave, të cilat nuk kërkohet të jenë të qarta, arrihet fuqizimi më i madh i strukturës familjare.

I njëjti person, Hysni Gashi, gjatë marrjes së tij në pyetje i është referuar kësaj strukture shoqërore, kur ka thënë se familja e tij (e gjerë) përbëhet nga më shumë se 160 anëtarë, duke deklaruar se ai do të kishte qenë në një pozicion të tillë që do të kishte mbledhur para nga anëtarët më në zë të familjes, me qëllim që ta blente ndërtesën e okupuar.

Për shkak të këtij vendimi, nuk është e nevojshme që ta shtjellojmë më tej këtë çështje. Rreziku i 'sociologjizmit' të përgjithshëm, i vendeve të njëjta që bazohet më shumë në përshtypje se sa në fakte, është gjithnjë i pranishëm në këtë lloj analize. Megjithatë, është mjaft e qartë se e gjithë historia, me epilogun e saj tragjik, është vendosur në një skenar i cili është i bazuar fuqimisht në vlerat tradicionale, dhe ndonjëherë edhe në interpretimin e gabuar të këtyre vlerave. Besnikëria ndaj familjes është gjë e mirë, por devocioni i tepruar ndaj vlerave që shprehet me anë të një individi, nuk është një gjë e mirë; respekti për babain është i rëndësishëm, por kur babai e vendos djalin në skenën e paligjshmërisë dhe brutalitetit, ai nuk duhet të ndiqet; mbrojtja e pronës është e nevojshme, por nuk mund të shkojë tek ato të mira që janë okupuar de facto, kur ato janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe kundër vendimit të Gjykatave.

Në përfundim, ky është një element mbështetës i vendimit të përgjegjësive së Hysni Gashit, i cili, sidoqoftë gjen arsytet të tjera, më të fuqishme, për t'u manifestuar, siç është thënë edhe më parë.

Përsa i përket përgjegjësive së Hysni Gashit, duhet adresuar edhe **një çështje tjetër**. Avokati i tij mbrojtës, z. Fazli Balaj, e ka kritikuar akuzën ndaj klientit të tij, si të paprovuar, aksiomatike, si një refleks të interpretimit të thjeshtë sociologjik, si një *cliché* në kulturën dhe strukturën e familjes në Kosovë.

Që të mbështetej ky përfundim, avokati mbrojtës tha se është e pamjaftueshme të merret në konsideratë se nxitja, sipas akuzës, duhet të kishte pasur për bazë një urdhër të veçantë për të vrarë dy individë dhe për të plagosur një numër të tjerësh, me treguesin paraprak të emrave të atyre që do të vriteshin e do të plagoseshin.

Një interpretim i tillë është i thjeshtë e banal, dhe nuk mund të lejohet.

Urdhri i dhënë të birit, për të vepruar e për të parandaluar me çdo kusht largimin nga toka që ishte e okupuar nga familja Gashi deri atëherë, dhe rrënimi i dyqanit që do të pasonte, i cili garantonte jetesën e familjes, ishte një recetë, që kur u dha, nuk mund të detajonte me saktësi numrin e njerëzve që do të plagoseshin e do të vriteshin. Vetë, nxitja, është një thirrje, një ftesë që nuk ka nevojë të jetë specifike.

Modalitetet për ta ekzekutuar urdhrin i janë lënë zgjedhjes së ekzekutuesit, duke pasur parasysh që të arrihet rezultati.

Gjendja mendore që e mbështet nxitjen, si *mens rea* për veprën penale me të cilën akuzohet Feriz Gashi, është një *dolus indeterminatus*.

Në gjendjen psikologjike, vullneti përqafton të gjithë veprimin, dhe nëse dimensionin përfundimtar dhe çdo pasojë e një veprimi kriminal mund të mos parashikohet që në konceptimin e vetë veprimit, pa dyshim, ato janë brenda kufijve të planit original. Më saktësisht, qëllimi i veprimit të Feriz Gashit (dhe i babait të tij, Hysniut) ishte fillimisht të ndalohej shpronësimi i pronës së okupuar prej tyre dhe e përdhosjes së nderit të familjes. Por kjo duhej bërë me çdo kusht, p.sh. edhe po të nënkuptonte që të vriteshin e të plagoseshin shumë njerëz. Vullneti i Ferizit kishte *pranuar* vetëm që masakra duhet bërë për hir të një vlere më të madhe, p.sh. për të ruajtur pronësinë e të mirave. Gjithashtu, po të përfshihej edhe bindja, ne po i referohemi ende qëllimit, të një vullneti që i ka peshuar të gjithë faktorët, pozitivë dhe negativë, por që rrjedhimisht ka marrë një vendim përfundimtar për të vepruar.

Kjo është e vërtetë edhe për nxitjen, e cila nuk mund të parashikonte (si mund të ishte e mundur?) paraprakisht prezencën dhe identitetin e një numri personash të familjes Bajrami apo pasojat e veprimit të të birirt. Megjithatë, fakti që i është drejtuar të birirt, me fjalë dhe shprehje të cilat janë të panjohura për ne, për të rezistuar ndaj rrënimin të ndërtesave ku gjendej edhe dyqani i familjes, Hysniu i kuptoi pasojat që mund të pasonin dhe i pranoi ato.

Si përfundim, gjendja mendore, *mens rea* është pothuajse e njëjtë me atë të Ferizit.

Përlllogaritja e dënimit:

Në përcaktimin e dënimit Gjykata duhet të respektojë kufijtë e përcaktuar me ligj për veprën penale, duke marrë në konsideratë rrethanat rënduese dhe lehtësuese si edhe çdo kriter tjetër, p.sh. qëllimin e dënimit, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës penale, shkallën e rrezikut apo rëndesën e e plagëve të shkaktuara, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjelljen në të kaluarën të kryesit të veprës, dhe në fund, rrethanat personale të kryesit të veprës penale dhe sjelljen e tij/të saj pas kryerjes së veprës penale. Eventualisht, dënimi do të jetë në proporcion me seriozitetin e veprës penale dhe sjelljen e rrethanat e kryesit të veprës, siç parashikohen me anë të Nenit 64, Par. 1 të Kodit Penal të Kosovës. (KPK).

Feriz Gashi është përgjegjës për dy vepra penale, Vrasje të Rëndë dhe Armëmbajtje të Paligjshme të Armës.

Për veprën e parë penale, Gjykata konsideron se Neni 147, Pikat 4 dhe 11 të KPK, parashikon një dënim me burgim prej të paktën dhjetë (10) vjetësh ose një dënim afatgjatë me burgim, ndërsa Neni 37, par. 2 i KPK, përcakton se dënimi afatgjatë me burgim do të thotë, një dënim prej njëzetë e një deri në dyzet vjet burgim.

Për veprën e dytë penale, Neni 328, Par. 2 i KPK, parashikon një dënim me gjobë deri në 7.500 Euro ose dënimin me burgim nga një deri në tetë vjet.

Duke filluar nga vepra më e rëndë penale (nga të dyja veprat e kryera prej tij) e kryer nga Feriz Gashi, Gjykata vëren se vrasjet e rënda dhe lëndimet që janë shkaktuar prej tij, janë veçanërisht të tmerrshme, shokuese dhe të papërshkrueshme.

Të tmerrshme, sepse modalitetet e kryerjes së veprës penale janë në disproporcion në lidhje me interesat që donte të mbronte Feriz Gashi. Armët dhe municionet që ai kishte përgatitur dhe që kishte sjellë me vete në dyqanin 'Cami', ishin të mjaftueshme për një masakër të një madhësie massive, dhe me të vertetë, falë rrethanave fatlume të shtënave me 57 plumba të qëlluara nga një armë automatike vetëm disa metra larg shënjestrës (Burim dhe Kadri Bajrami ishin më pak se 10 metra larg) nuk shkaktuan më shumë viktima.

Shokuese, sepse Feriz Gashi tregoi një mosrespekt të përgjithshëm për jetët e njerëzve të tjerë dhe për integritetin fizik të viktimave, të cilët nuk kishin të bënin fare me mosmarrëveshjen dhe ishin thjeshtë kalimtarë ose po qëndronin thjeshtë në dritare (si vajza e vogël, Albiona Jashari), ose ishin persona që madje kishin ndihmuar në ndërmjetësimin mes familjeve (si Xhelal Azizi).

Të papërshkrueshme, sepse sulmi ishte i papritur, të paktën në përmasat e tij dhe në llojin e armëve të përdorura nga sulmuesi (një armë automatike dhe tri granata dore) kundër një grupi të papërcaktuar njerëzish.

Trupi Gjykues ka ilustruar më parë prejardhjen psikologjike e cila e ka detyruar Ferizin të vepronte: një djalë që jetonte nën të njëjtën çati me të atin, ai është frymëzuar të veprojë nën presionin e dëshirës së të atit, për të respektuar vlerat dhe për të përmbushur detyrimet morale që i ishin mësuar atij nga babai. Duhet shtuar se, vlerat e paqarta, apo të paktën të interpretuara në një mënyrë të paqartë, apo sfera ku mbrojtja e pronës peshon më shumë se jeta njerëzore dhe integriteti i emrit dhe i nderit të familjes, mund të çojnë në shkeljen e ligjit.

Prokurori i ka treguar Gjykatës se Hysniu dhe Ferizi janë të bashkuar në ndërmarrjen kriminale me anë të forcës së një vullneti që është unik, një qëllim që pasohet nga i pari tek i dyti, duke i transmetuar ekzekutuesit të veprës penale (Ferizit), pasionet, zhgënjimin, shpresat e nxitësit. Është diçka që i ngjit të dy anëtarët e familjes në të njëjtën mënyrë në të cilën vlerat reflektohen në veprimin kriminal të familjes Gashi.

Panorama që paraqet Prokurori është e qëndrueshme, (siç beson edhe Gjykata), që përfaqësimi duhet të sillet tek pasojat e natyrshme, duke deklaruar se ky element psikologjik i unifikimit mes babait dhe djalit, ku i dyti është ekzekutuesi dhe i pari është mendja (apo truri*) pas veprimit, kjo saktëson ndarjen e përgjegjësisë dhe jo shumimin e saj. Me fjalë të tjera, ishin përfshirë dy njerëz, sepse ata ndanin të njëjtin vullnet, jo si dy individë që vendosin të bashkojnë forcat në kryerjen e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, por më tepër, si një individ i vetëm, që vepron pasi merr vendimin për të vrarë. Hysniut i atribuohet vendimi, ndërsa Ferizit i atribuohet ekzekutimi.

Argumenti paraprak, nuk mund të na çojë në një reduktim automatik të dënimit, por është një rrethanë që do të merret në konsideratë kur të përcaktohet dënimi, e cila e ndihmon Gjykatën ta vendosë veprën penale në perspektivën e duhur. Siç është thënë edhe më parë, Feriz Gashi nuk është dënuar ndonjëherë më parë; deri ditën para ngjarjes, ai ishte një njeri i thjeshtë, një qytetar i respektuar me një profesion të thjeshtë, ndërsa të nesërmen ai u kthye në një vrasës brutal. Ky shpërthim i papritur dhune nuk 'i përket' Ferizit në kuptimin që në jetën e tij të mëparshme ai nuk ka baza të tilla, shenja të një natyre të dhunshme, tregues të një personaliteti që ziente (nervoz*), që ishin të predispozura të shpërthenin dhe që tërhiqeshin nga brutaliteti.

Prandaj dënimi duhet të marrë në konsideratë të gjitha këto, dhe nuk mundet që thjeshtë të udhëhiqet drejt spektrit më të rëndë (afër dënimit maksimal prej 40 vjetësh).

Për veprën penale të paraparë me anë të Nenit 328 të Kodit Penal, dënimi shtesë me një vit burgim është adekuat dhe shkrihet në dënimin tjetër, sipas Nenit 71, Par. 1 dhe 2, Pika 2 e Kodit Penal të Kosovës, me qëllim që të përcaktohet dënimi përfundimtar me burg në 25 vjet e 6 muaj.

Në rastin e marrjes së vendimit për dënimin e Hysni Gashit, Gjykata ka parasysh Nenet 24 dhe 147, Pikat 4 dhe 11 të Kodit Penal të Kosovës, që përcakton një dënim me burgim prej të paktën dhjetë (10) vjetësh, ose një burgim afatgjatë. Neni 37, Par. 2 i Kodit Penal të Kosovës parasheh se dënimi me burgim afatgjatë është dënimi me burgim nga njëzetë e një (21) vjet deri në dyzet (40) vjet.

Në bazë të Neneve 38 dhe 24 të Kodit Penal të Kosovës, lidhje me Nenin 147, Par. 1, Pikat 4 dhe 11 të Kodit Penal të Kosovës, Hysni Gashi dënohet me njëzetë (20) vjet burgim, duke pasur parasysh rolin e nxitësit dhe moshën e tij të thyer.

Koha e shpenzuar në paraburgim do të përfshihet në sasinë e dënimit.

Padia Pronësore

Paditë e dorëzuara nga palët e lënduara konfirmohen gjerësisht nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët, si edhe nga dokumentet e dosjes së lëndës. Natyra dhe serioziteti i lëndimeve konfirmohen nga raporti i dëshmitarit ekspert dhe nga dëshmia e tij në Gjykatë gjatë marrjes në pyetje.

** Shënim i Përkthyeses: Fjalët në kllapa janë shtuar për të qartësuar kuptimin e fjalës paraardhëse.*

Për këtë arsye, të akuzuarit, së bashku dhe veçanërisht, do të kompensojnë palët e lënduara, Gojart Bajrami, Nazif Xhelili, Burim Bajrami, Kadri Bajrami, Besnik Ferati, Rifat Imeri, Hamdi Hasani, Xhemajl Smajli, Albiona Jashari, Fitim Ferati, për dëmet e shkaktuara.

Megjithatë, të dhënat e siguruara në procedurën penale nuk përbëjnë një bazë të qëndrueshme për asnjërin prej tyre në lidhje me kompensimin e plotë apo të pjesëshëm.

Siç parashikohet me anë të Nenit 112 (2) të KPPK, palëve do tju duhet të ushtrojnë padi civile me qëllim që të kenë një vlerësim përfundimtar në lidhje me sasinë e dëmeve.

Konfiskimi

Në bazë të Nenit 60 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenit 489 të KPPK, arma automatike e Tipit 68, me numrin serial 10232985, e kalibrit 7. 62mm x 39 mm, konfiskohet.

Shpenzimet e Proedurës Penale

Në bazë të Neneve 102, Par. 1 dhe 3, dhe 391, Par. 1, Pika 6 të KPPK, të pandehurit, së bashku dhe në nëmyrë të veçantë janë përgjegjës për shpenzimet e procedurës penale dhe duhet të riimburojnë këto shpenzime sipas një liste shpenzimesh, e cila do të përcaktohet në kohën e duhur.

Në bazë të Nenit 100, Paragrafi 2 të KPPK, meqë të dhënat në lidhje me sasinë e shpenzimeve mungojnë, do të dorëzohet një vendim i veçantë në lidhje me to.

26 Mars 2009

Kryetar i Trupit Gjykses
Francesco Florit

Anëtar i Trupit Gjykses
Andrea Cruciani

Anëtar i Trupit Gjykses
Hamdi Ibrahim

Proçesmbajtëse
Liz Bateman

KËSHILLË LIGJORE:

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh që marrin kopjen e tij, sipas Nenit 398, Paragrafi 1 të Kodit të Proedurës Penale të Kosovës (KPPK), në Gjykatën Supreme të Kosovës, përmes Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.